

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **217-26-2696-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet, Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit për nevojat e FSK-së.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Best D.D.D. SH.P.K.
NUI	812147339
Adresa	Vellezrit Gervalla
Vendi	Ferizaj
Kodi postar	70000
Numri Telefonit	049851805
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Florian Syla
Adresa elektronike	floriansyla23@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	29.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Shërbimet, Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit për nevojat e FSK-së.

B05 Njoftim per Kontrat 28.04.2026 00:00

SHQIP Dosja e Tenderit e permiresuar 21.05.2026.Docx21.05.2026 09:48

Kerkese per rishqyrtim - Best D.D.D. SH.P.K. 20.05.2026 16:12

Njoftim për pezullim 21.05.2026.pdf 21.05.2026 09:50

Vendim nr. 2767. Date 22.05.2026.pdf 22.05.2026 14:59

Pergjigje lidhur me kerkesat per sqarime..pdf 25.05.2026 13:28

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A

te LPP-se.

Kerkese per rishqyrtim - Best D.D.D. SH.P.K. 20.05.2026 16:12

Vendim nr. 2767. Date 22.05.2026.pdf 22.05.2026 14:59

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

Neni 28 - Specifikimet teknike

Neni 66 - Përshtatshmëria Profesionale

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

ANKESË

Kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues Ministria e Mbrojtjes, për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit për nevojat e FSK-së", me nr. të prokurimit 217-26-2696-2-2-1.

Ne, OE Best D.D.D. SH.P.K., brenda afateve ligjore kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj Dosjes së Tenderit dhe kritereve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke ngritur pretendime konkrete lidhur me kërkesa të cilat i konsiderojmë joproporcionale, kufizuese, të paqarta dhe jo në përputhje me natyrën e shërbimeve objekt i kontratës.

Me Vendimin nr. 2767, të datës 22.05.2026, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim si të pabazuar dhe ka vërtetuar Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Megjithatë, në arsyetimin e këtij vendimi, AK nuk ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe konkrete secilin pretendim të ngritur nga OE, por kërkesën tonë për rishqyrtim e ka konsideruar si kërkesë për informacion/sqarime lidhur me specififikimet teknike.

Më pas, me dokumentin e datës 25.05.2026, "Përgjigje lidhur me kërkesat për sqarime", Autoriteti Kontraktues ka dhënë sqarime shtesë dhe në disa pika ka pranuar se në Dosjen e Tenderit ka pasur lëshime teknike dhe formulime që duhet të korrigjohen. Kjo dëshmon se pretendimet tona nuk kanë qenë thjesht kërkesa për informacion, por pretendime konkrete lidhur me paqartësi, disproporcionalitet dhe mangësi në dokumentacionin e tenderit.

Përkundër kësaj, AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar, ndërkohë që vetë përgjigja e mëvonshme e datës 25.05.2026 konfirmon se disa nga çështjet e ngritura nga OE kanë pasur bazë dhe kanë kërkuar korrigjim apo sqarim. Në këtë mënyrë, vlerësojmë se vendimi i AK-së nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm dhe nuk i trajton në mënyrë substanciale pretendimet tona, duke cenuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së hapur dhe proporcionalitetit.

Përmes kësaj ankese, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtojë pretendimet tona të paraqitura në vijim, të vlerësojë ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e kërkesave të kontestuara në Dosjen e Tenderit, si dhe të konstatojë se Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim të plotë dhe të mjaftueshëm për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi nr. 1 Kërkesa 10 dhe Evidenca 10

Ne, OE Best D.D.D. SH.P.K., kundërshtojmë Kërkesën 10 dhe Evidencën 10, në veçanti pikën C të Evidencës 10, përmes së cilës Autoriteti Kontraktues kërkon që për të gjithë stafin e kërkuar të dorëzohen kopjet e diplomave/certifikatave, CV-të. Kjo kërkesë, në formën aktuale, është joproportionale dhe kufizuese, sepse shërbimet e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit janë shërbime teknike-operative dhe nuk kërkojnë domosdoshmërisht kualifikim akademik për çdo punëtor operativ. Në këtë sektor, puna në terren kryhet edhe nga teknikë operativë me përvojë praktike, të cilët mund të jenë të aftë për realizimin e shërbimeve, edhe pse nuk posedojnë diploma universitare apo certifikata formale individuale.

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e datës 25.05.2026, e arsyeton këtë kërkesë me faktin se gjatë shërbimeve përdoren substanca të rrezikshme për shëndetin e njeriut. Ne nuk e kontestojmë rëndësinë e sigurisë gjatë përdorimit të preparateve DDD. Megjithatë, ky arsyetim nuk e justifikon kërkesën që për secilin punëtor operativ të dorëzohen diploma dhe certifikata individuale. Siguria gjatë përdorimit të preparateve sigurohet përmes licencimit të operatorit ekonomik e cila deshmohet përmes lejes së perkoheshme nga MBPZHR, përdorimit të preparateve të autorizuar, respektimit të udhëzimeve të prodhuesit, fletëve të sigurisë dhe organizimit profesional të punës në terren. AK nuk ka dëshmuar lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet diplomës apo certifikatës individuale të çdo punëtori dhe aftësisë reale për kryerjen e shërbimit. Po ashtu, AK nuk ka treguar ndonjë dispozitë konkrete ligjore apo licencuese ku parashihet se çdo punëtor operativ në shërbimet DDD duhet të ketë diplomë apo certifikatë individuale si kusht për pjesëmarrje

në tender.

Në këtë mënyrë, kërkesa në formën aktuale krijon barrë formale dhe pengesë të panevojshme për operatorët ekonomikë. Një operator i licencuar dhe me përvojë mund të kufizohet në pjesëmarrje vetëm për shkak se stafi operativ nuk posedon diploma apo certifikata individuale, edhe pse shërbimi mund të realizohet në mënyrë profesionale dhe të sigurt përmes stafit me përvojë praktike dhe organizimit të duhur profesional. Kjo kërkesë bie ndesh me parimin e proporcionalitetit, konkurrencës së hapur dhe trajtimit të barabartë, pasi tejkalon atë që është realisht e nevojshme për realizimin e kontratës. AK duhet të vendosë kritere të arsyeshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, e jo kërkesa formale që mund ta ngushtojnë konkurrencën pa nevojë objektive.

Prandaj, kërkojmë nga OSHP që ta vlerësojë këtë pretendim si të bazuar dhe të konstatojë se Kërkesa 10, respektivisht Evidenca 10 pika C, në formën aktuale paraqet barrë dokumentare joproporcionale për operatorët ekonomikë. Kërkojmë që AK të udhëzohet për rishikimin dhe riformulimin e kësaj pike, në mënyrë që dëshmitë e kërkuara për stafin të jenë të qarta, proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e shërbimeve objekt i kontratës, pa u kërkuar në mënyrë të përgjithshme diploma dhe certifikata individuale për secilin punëtor operativ.

Pretendimi nr. 2 Kërkesa për repelentë kundër brejtësve dhe pajisje ultrasonike

Ne, OE Best D.D.D. SH.P.K., kundërshtojmë kërkesën e përcaktuar në specifikimet teknike, pika c), ku AK ka paraparë që në disa objekte, si vendet elektrike, depot e tekstileve etj., përreth hyrjeve të vendosen produkte repelente adekuate kundër brejtësve në formë granulash apo sprej, me origjinë organike, jo të rrezikshme për njerëzit dhe mjedisin, si dhe që përreth depove të municionit të vendosen pajisje ultrasonike me rreze veprimi minimale 200 m². Në kërkesën tonë për rishqyrtim kemi theksuar se kjo kërkesë është e tepruar dhe jo proporcionale, sepse për deratizim vetë Dosja e Tenderit ka paraparë përdorimin e preparatit deratizues rodenticid-antikoagulant të gjeneratës së dytë, në formë blloku me parafinë, të vendosur në stacione/shtëpiza speciale me siguresa, me paralajmërimet përkatëse dhe sipas udhëzuesit të produktit. Në këtë kuptim, kërkesa shtesë për repelentë organikë në formë granulash apo sprej e ngushton mënyrën e realizimit të shërbimit dhe imponon produkte të veçanta, pa u arsyetuar pse këto janë të domosdoshme për arritjen e efektit të deratizimit.

Në përgjigjen e datës 25.05.2026, AK është fokusuar kryesisht te arsyetimi se objektet janë të ndjeshme dhe se brejtësit mund t'u shmangen kutive deratizuese, prandaj kërkohen pajisje ultrasonike si masë shtesë. Mirëpo, AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete ndaj pretendimit tonë se kërkesa për repelentë organikë në granula apo sprej është kufizuese dhe jo esenciale për procesin e deratizimit. Po ashtu, AK nuk ka arsyetuar pse pajisjet ultrasonike duhet të jenë të detyrueshme, pse është vendosur rrezja minimale prej 200 m² dhe pse nuk mund të pranohen zgjidhje të tjera profesionale që sigurojnë kontrollin dhe parandalimin e brejtësve. Fakti që AK kërkon siguri më të lartë në objekte të ndjeshme nuk kontestohet nga ana jonë. Ajo që kontestohet është vendosja e produkteve repelente organike dhe pajisjeve ultrasonike si kushte të detyrueshme teknike, pa arsyetim të

mjaftueshëm dhe pa lidhje të domosdoshme me rezultatin e shërbimit. Kjo kërkesë e orienton ofertimin drejt produkteve dhe pajisjeve të caktuara, krijon barrë teknike të panevojshme dhe mund të kufizojë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Prandaj, kërkojmë nga OSHP që ta vlerësojë këtë pretendim si të bazuar dhe të konstatojë se kërkesa e përcaktuar në pikën c), në pjesën që ka të bëjë me repelentët organikë në formë granulash apo sprej dhe pajisjet ultrasonike me rreze minimale 200 m2, në formën aktuale paraqet kusht joproporcional dhe kufizues për operatorët ekonomikë. Në përputhje me parimet e prokurimit publik për proporcionalitet, trajtim të barabartë dhe konkurrencë të hapur, kërkojmë që këto kushte të largohen, në mënyrë që të mos imponohen produkte apo pajisje të caktuara si kushte të detyrueshme teknike dhe të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë dhe konkurrencë e drejtë.

Pretendimi nr. 3 Kërkesa për preparate "ekologjike" në dezinfektimin e jashtëm

Ne, OE Best D.D.D. SH.P.K., kundërshtojmë kërkesën e përcaktuar në specifikimet teknike për dezinfektimin e hapësirave të jashtme, ku AK ka kërkuar që preparatet të jenë "ekologjike", ndërsa në të njëjtën pikë ka paraparë përdorimin e preparateve në formë koncentratesh me materie aktive si Permetrine, Deltametrine, Cypermetrine, Esbiothrine, Piperonyl Butoxide apo ndonjë preparat tjetër ekuivalent. Kjo kërkesë është kontradiktore dhe teknikisht e pasaktë, sepse materiet aktive të përmendura nga vetë AK në DT janë materie aktive të përdorura në preparate biocide/insekticide për kontrollin e insekteve, ndërsa termi "ekologjike" nuk është përcaktuar si kriter teknik i matshëm. AK nuk ka sqaruar se si një preparat me këto materie aktive do të vlerësohet si "ekologjik", çfarë dokumenti duhet të dorëzohet për ta dëshmuar këtë dhe mbi cilin standard do të bëhet vlerësimi.

Në kërkesën tonë për rishqyrtim kemi kundërshtuar pikërisht këtë formulim, sepse krijon paqartësi dhe mundësi interpretimi subjektiv gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të ofertave. Mirëpo, në përgjigjen e datës 25.05.2026, AK nuk i është përgjigjur kësaj çështjeje. AK është përgjigjur për dezinfektimin e brendshëm, duke iu referuar "gellit ekologjik" kundër insekteve zvarritëse dhe duke theksuar se metoda e aplikimit mund të konsiderohet ekologjike. Kjo përgjigje nuk lidhet me pretendimin tonë, sepse ne nuk kemi kontestuar metodën e aplikimit të gellit në hapësira të brendshme, por kërkesën që preparatet koncentrate për dezinfektim të jashtëm të jenë "ekologjike".

Në këtë formë, AK ka lënë pa përgjigje thelbin e pretendimit tonë dhe nuk ka sqaruar se si do të vlerësohet ky kriter gjatë ofertimit dhe cilat dëshmi do të pranohen për ta konsideruar një preparat si "ekologjik". Si pasojë, kërkesa mbetet e paqartë, kontradiktore dhe jo e matshme, duke krijuar pasiguri për operatorët ekonomikë dhe hapësirë për vlerësim subjektiv. Kjo mund të ndikojë në trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe në konkurrencën e drejtë, pasi ofertuesit nuk kanë një kriter të qartë teknik mbi të cilin duhet të bazojnë ofertën e tyre.

Prandaj, kërkojmë nga OSHP që ta vlerësojë këtë pretendim si të bazuar dhe të konstatojë se kërkesa për preparate "ekologjike" në dezinfektimin e jashtëm, në formën aktuale, është

e paqartë, kontradiktore dhe jo e matshme. Në përputhje me parimet e prokurimit publik për proporcionalitet, transparencë dhe trajtim të barabartë, kërkojmë që kjo kërkesë të largohet.

Pretendimi nr. 4 Kërkesa për preparate repelente kundër insekteve në formë granulash

Ne, OE Best D.D.D. SH.P.K., kundërshtojmë kërkesën e përcaktuar në specifikimet teknike, pika b), ku AK ka kërkuar që në hapësira gjelbëruese dhe terrene fushore të përdoren preparate repelente kundër insekteve në formë granulash, me origjinë natyrale, me materie aktive si citronela, allium, sativum ose ekuivalente. Kjo kërkesë është kufizuese, e tepruar dhe jo proporcionale, sepse e detyron operatorin ekonomik të përdorë pikërisht preparate repelente në formë granulash, pa dëshmuar pse kjo formë produkti është e domosdoshme për realizimin e dezinfektimit të jashtëm. Qëllimi i kontratës është kontrolli dhe eliminimi i insekteve, jo imponimi i një forme të caktuar produkti apo i materieve aktive të caktuara.

Në përgjigjen e datës 25.05.2026, AK nuk ka dhënë arsyetim real për këtë kërkesë. AK vetëm e ka përsëritur formulimin se mund të përdoren citronela, allium, sativum apo preparate ekuivalente, por nuk ka shpjeguar pse repelentët në formë granulash janë të nevojshëm, pse janë proporcionalë dhe pse nuk mjaftojnë preparatet biocide të autorizuara për dezinfektim, të cilat vetë DT i ka paraparë për eliminimin e insekteve zvarritëse dhe fluturuese. Në këtë formë, kërkesa e orienton ofertimin drejt produkteve të caktuara dhe krijon kufizim të panevojshëm për operatorët ekonomikë.

Prandaj, kërkojmë nga OSHP që ta vlerësojë këtë pretendim si të bazuar dhe të konstatojë se kërkesa për preparate repelente kundër insekteve në formë granulash duhet të largohet, në mënyrë që të mos imponojë një produkt të caktuar si kusht të detyrueshëm teknik dhe të mundësojë konkurrencë të drejtë.

Nga të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më lartë, si dhe duke marrë parasysh se Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe të argumentuar pretendimet tona të ngritura në kërkesën për rishqyrtim, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të marrë:

VENDIM

1. Të aprovohet si e bazuar ankesa e OE Best D.D.D. SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet, Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit për nevojat e FSK-së", me nr. të prokurimit 217-26-2696-2-2-1.
2. Të anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues " Ministria e Mbrojtjes, nr. 2767, i datës 22.05.2026, për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE Best D.D.D. SH.P.K.
3. Të kërkohet nga Autoriteti Kontraktues rishikimi dhe korrigjimi i Dosjes së

Tenderit, duke larguar kërkesat teknike dhe profesionale të kontestuara, të cilat në formën aktuale janë joproporcionale, kufizuese, të paqarta ose jo të matshme teknikisht.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Pamundësia për pjesëmarrje në tender për shkak të kriterëve të padrejta.

Humbja e mundësisë për përfitim ekonomik nga kontrata.

Shpenzime të panevojshme për përmbushjen e kërkesave jo relevante.

Dëmtim i pozitës konkurruese në treg.

Humbje e kohës dhe resurseve në përgatitjen e ofertës.

Kufizim i të ardhurave potenciale të operatorit ekonomik.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*